

## PERSHRIMI PROJEKTIT

Objekt 1 kat

Siperfaqja - 1016 m<sup>2</sup>

Lertesia Maksimale-10.8 m



### KUSHTET DHE ARSYET

Puka është një qytet dhe një qendër e banuar në zhvillim e sipër si nga zgjerimi urban ashtu edhe në nivelin e jetesës e cila po ecën me ritme progresive shumë të shpejta. Këto ritme kërkojnë ritje të standardeve në zhvillimin e aktiviteteve që përfshinë qytetin në përgjithsi dhe sistemin arsimor në vecanti. Bazë për plotësimin e këtyre kushteve është investimi tek infrastrukturën mbështetëse të sistemit arsimor që perfaqsohet nga të gjitha grupmoshat përfshirë në të. Në Pukë është ndër mungesa e një palestere bashkëkohore dhe në pamundësi për të pasur një godinë të posaçme dhe të projektuar për këtë qëllim janë krijuar kushte provizore në ambientet ekzistuese të objekteve shkollore, në kushte të pa favorshme për zhvillimin e aktivitetit sportiv në ambiente të duhura. Është shumë e rëndësishme për vetë moshën që e frekuenton kompleksin shkollor, i cili përmbledh tre godina në të tre ciklet para shkollor, fillor, nëntë vjeçar dhe të mesëm që ky kompleks të përfshinte dhe një strukturë shtesë për aktivitetet sportive.

Duke pasur parasysh këto kushte është menduar të ndërtohet një godinë e re e projektuar posaçërisht për këtë qëllim duke respektuar normat dhe kushtet e komunitetit evropian në lidhje me qëllimin dhe funksionin. Kjo godinë do të plotësojë më së miri kërkesat dhe nevojat e zonës për një qendër të edukimit sportiv të fëmijëve , e cila do të japë një hap përpara vetë zhvillimit të qytetit.

## POZICIONIMI


Godina e palestrës është vendosur pranë kompleksit shkollor në qytetin e Pukës në mënyrë që të jetë lehtësisht e arritshme, në funksion të gjithë strukturës shkollore dhe jo vetëm, në një shesh aktualisht të pa zënë me ndërtime të tjera përveç grupit të godinave shkollore ekzistuese.




Orientimi i ndërtesës është i përcaktuar nga kompozimi dhe mundësia që na jep sheshi ekzistues, vendosur në mënyrë që të jetë sa më i përshtatshëm për funksionin ashtu edhe për plotësimin e kushteve të përdorimit të godinës. Nga ana veriore është menduar hyrja kryesore prej nga do të hyjnë vizitorët dhe frekuentuesit e saj dhe kjo përkon dhe me rrugën ekzistuese. Gjithashtu fasada veriore është dhe fasada kryesore e godinës, ndaj dhe kujdesi për trajtimin e saj është i vecantë sidomos në trajtimin në rifiniturë. Ndërkohe që fasadat e tjera kanë mjaftueshëm hapje që janë më të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit si në stinën e ftohtë është dhe në ato të nxehtë të vitit. Ato lejojnë dritën e diellit të depertoje në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo reflektive, dhe kjo është një vecori që e bën godinën të përshtatet më mirë natyrës së funksionit pasi është një godinë e cila do të frekuentohet nga një moshe aktive

## KONCEPTI dhe FUNKSIONI

Grup moshat të cilat do ta frekuentojë këtë strukturë sportive është një grup moshë tepër aktive dhe delikate dhe ky aspekt është patur parasysh pasi struktura duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme loje në rradhë të parë dhe më pas në ambjentet ndihmëse. Ky aspekt kaq i rëndësishëm vihet re dhe në zgjidhjen planimetricë të godinës e cila është e qartë dhe e pastër në funksionet e sajë. Holli i hyrjes ka në të dyja anët hapësirat për cveshje dhe dushe. Kapaciteti 10-12 sportistë hapësira 1, 15-18 sportistë hapësira 2. Ambjenti i i zyrës ka dhe funksionin e infirmjerisë në rast kur është e nevojshme për këtë. Volumet e përdorura i përshtaten më së miri normave të kërkuara për ndërtime të këtij lloji me lartësi që sigurojnë ajër dhe ndricim të mjaftueshëm.



Kjo është një godinë e cila është trajtuar me kujdes të vecantë në të katër fasadat e saj dhe një godinë interesante imazhi i të ciles nuk të shfaqet njëherësh por me levizjen e vizitorit shfaqet dhe imazhi plote i saj i cili duket sikur zhvillohet përgjate kësaj levizjeje. Godina është e lartë për tju përgjigjur më mirë shkallës së rëndësisë dhe funksionit të këtij objekti një kateshe por pa dashur të krijojë pamjen e një objekti shkollor por të një strukture mikpritse ku kalohen orët me aktive dhe sigurisht dhe më të gezuara në përdhën shkollore. Si e tillë është menduar dhe futja e një strukture metalike për spektatorë me një kapacitet maksimal 250 spektatorë.



Zgjidhja funksionale e ndërtesës është e thjeshtë. Holli kryesor në të cilin bashkohen flukset e levizjes ka dimension të mjaftueshëm për këtë. Ndryshe nga godinat e tjera palestra është një godinë e cila duhet ti bashkoje dhe jo ti ndaje flukset e lëvizjes pasi duhet të lindin dhe krijohen mardhenie miqësie midis vetë fëmijeve pasi është një moshe e cila po hedh hapat e para në këtë drejtim dhe kjo është një pjesë e vetë edukimit. Hapsirat brenda janë tepër dinamike dhe i japin mundësi aktivitetit sportiv të zhvillohet në kushte optimale. Nga ana funksionale këto hapsira i plotësojnë normat dhe kushtet që i nevojiten një ndërtesë me një funksion të tillë. Në qendër të saj është

vënë fusha e basketbollit me dy tabela të parashikuar sipas standarteve të FIFA-s bashkë me dyshtemenë e drurit me specifikime të qarta për këtë lloj aktiviteti. Gjithashtu për nga funksioni ato janë menduar dhe zgjidhur në formë të tillë për të lejuar transformimin në një të ardhme nëq kjo do të jetë e nevojshme. Behet fjalë për përdorimin e kësaj hapsire me shume se vetem për aktivitete sportive si shfaqje, konferenca e aktivitete të ndryshme në nivel shkollash dhe me gjerë në nivel qyteti. Holli i katit përdhe është dinamik dhe krijon lidhje të drejtperdrejte me hyrjet e grupeve të vecanta. Dyert janë menduar të hapen nga jashte pasi kjo është konform normave tëkomunitetit evropian për mbrojtjen ndaj zjarrit, termetit etj.

Nyjet sanitare janë të grupuara pranë dhomave të cveshjes dhe njëra që do të shërbejë spektatorëve apo personelit të shërbimit të godines. Janë menduar të tilla pasi fëmijet duhet tu sigurohen kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Ndërkohë që stafi do të ketë nyjet e veta të higjenes të cilat do të jenë të ndara nga ato të femijeve.

Struktur ka të përfshirë një sistem ngrohje të vecantë që ka të bëjë me faktin që Puka është një qytet me klimë të fortë kontinentale me temperatuerë shumë të ulta në dimër.

Në thelb të zgjidhjes arkitektonike mbetet respekti për vendin dhe njerzit, pa u imponuar, duke ritur cilësinë po mbi të gjitha duke ofruar një ndërtim që do të ketë vullën e ndërtimit me karakter lokal. Për detaje të zgjidhjes arkitektonike, konstruktive dhe inxhinjere referohuni projektit bashkangjitur këtij materiali.

